   a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër; ☐

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

☐

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

a) çmimet ;
b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

______________________________________________________________

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

________________                    _____________________

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

**Shtojca 4 -** ***NUK APLIKOHET***

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*]

**FTESA PËR OFERTË**

(*shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor*)
fton për të paraqitur oferta në procedurën për kryerjen e shërbimeve të mëposhtme:
……………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………
………………
(*jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasisë siç përkufizohet në Dokumentacionin e Tenderit (DT)).*

<u>Vendi i kryerjes së shërbimit</u>
*(jepni një përshkrim të shkurtër)*

Kohëzgjatja e shërbimit ______________________

Oferta duhet të paraqitet
……………………………………………………………………………………………
……[*Jep adresën e saktë*]
Përpara
……………………………………………………………………………………………
…
[*Përcaktoni datën dhe orën e afatit përfundimtar*]

Forma e komunikimit:

Me shkrim __ Elektronik ( email, fax etj.) _____

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

**Shtojca 5**

[*Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[ *Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik, kur kërkohet nga autoriteti kontraktor*]

**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

[Data _______]

Për: *[Emri dhe adr esa e autoritetit kontraktor]*

Në emer të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[ objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr.references ne faqen e APP-se*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës ose ftesën për tender*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

**Shtojca 6**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL**

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial | Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**KUJDES**

Çdo e dhënë, që nuk është regjstruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**V ula**

**Shtojca 7**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Unë i nënshkruari _______________,me cilësinë e ________ të personit juridik _______________deklaroj se:

Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**V ula**

**Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**
**Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

  Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtj ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____________________, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _______________deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

____________________________

Vula

**Shtojca 9**

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt ____________________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilesinë ___________të operatorit ekonomik ____________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik ______________________ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik,*** si më poshtë:

***(emer, atesi, amesi, mbiemer, ditelindje dhe numri personal i identifikimit)***

_____________________
_____________________
_____________________etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP[3].

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik ____________________ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

[3] Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

- Operatori ekonomik ____________________ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**
**Nënshkrimi i ofertuesit ______________**

**Vula ______________**

**Shtojca 9/1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në proçedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt _______________me fond limit __________.

Unë i nënshkruari __________________me cilësinë e ___________të operatorit ekonomik __________________, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik ________________________garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

- Operatori ekonomik___________________lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik ________________nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës _____________**
**Përfaqësuesi i ofertuesit**
**Nënshkrimi**
**Vula**

**Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, dokumentet (a)-(d) më sipër duhet të dorëzohen nga seicili prej anëtarëve të bashkimit. Duhet të dorëzohen gjithashtu:**

**a.** Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

**b.** Prokura e posacme.

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5,* ***(referohuni në Seksionin 3, pika 1 të DST)****;*
*b. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 7;*
*c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;*
*ç. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 9/1:*

*d.Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

**Për dorëzim në Fazën e Dytë:**

*e. Plani Operacional,*
*f. Plani i propozuar mbi Permiresimin Teknik te Terminalit,*

*g. Propozimi mbi implementimin e Sistemit lnformativ dhe Menaxhues te Terminalit te Konteinereve,*

*gj. Plani i burimeve njerezore,*

*i. Plani i marketingut,*

*j. Plani i biznesit*

**3**. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë themeluar në formën e personit juridik. Ofertuesi, përfshirë anëtarët e Bashkimit të Përkohshëm dhe ortakët e tij nuk duhet të jetë e rregjistruar në vende të njohura si parajsa fiskale/offshore.

   Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron që nuk eshtë i rregjistruar në vende të njohura si parajsa fiskale/offshore.

2. Ofertuesi duhet të dëshmoje përmes dokumentave ligjorë se cili është pronari i fundit përfitues (ultimate beneficial owner). Nuk lejohet që ortaket të jenë të ashtequajturit *nominë* – apo të tretë që mbajnë kuotat në kuadër të një marrëveshjeje, me qëllim fshehjen e identitetit të ndonjë ortaku. Ky kusht duhet të respektohet si gjatë fazës së prokurimit, ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës, me pasojë skualifikimin dhe/ose zgjidhjen e kontratës.

3. Nuk lejohet pjesëmarrja e Ofertuesve të cilën janë apo kanë për ortakë/aksionarë, pavarësisht pjesëmarrjes dhe në mënyrë direkte ose indirekte (p.sh. përmes ortakut të ortakut) të cilët zhvillojnë veprimtari në sektorin e linjave të transportit detar. Me qëllim vërtetimin e këtij kushti, shoqëria do të sjellë ekstrakte nga regjistri tregtar të shoqërive ortakte dhe shoqërive të tjera të lidhura, sipas rastit. Ky kusht duhet të respektohet si gjatë

fazës së prokurimit, ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës, me pasojë skualifikimin dhe/ose zgjidhjen e kontratës.

Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron që si gjatë fazës së prokurimit, ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës, nuk kanë dhe nuk do kenë ortakëri direkte apo indirekte me shoqëri që zhvillojnë veprimtari në sektorin e linjave të transportit detar.

**3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Ofertuesi duhet të dëshmojë se xhiroja e realizuar në seicilin nga tre vitet e fundit: 2017, 2018 dhe 2019, nuk është më e vogël se 40% e vlerës limit të kontratës ( kontrata 5 vjecare) e përllogaritur në bazë vjetore.

2. Ofertuesi duhet të ketë një kapital minimal të vetin të shlyer plotësisht, të paktën 40% e vlerës limit të kontratës.

   Për vërtetimin e kushteve (1) dhe (2) më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë kopje të certifikuara të pasqyrave financiare të viteve: 2017, 2018 dhe 2019, të dorëzuara pranë autoriteteve përkatëse dhe të konfirmuara nga subjekte auditimi të njohura në përputhje me legjislacionin në fuqi në vëndin e origjinës. Në rast se në përputhje me ligjin e vendit të ofertuesit/shoqërisë që dorëzon pasqyrat financiare, pasqyrat financiare mbyllen/dorëzohen në një datë më të vonë nga data e dorëzimit të dokumenteve në këtë procedurë konkurruese, ofertuesi mund të dorëzojë pasqyrat financiare të tre viteve të fundit të dorëzuara, respektivisht 2016, 2017 dhe 2018.

**3.3 Kapaciteti teknik:**

1. Ofertuesi duhet të dëshmojë eksperiencë në kryerjen e shërbimeve të mëparshme, të ngjashme, gjatë secilit prej tri viteve të fundit lidhur me trajtimin e kontejnerëve në port/porte detare, për të paktën 40% e vlerës se volumeve në referencë të vlerës së përllogaritur të të gjithë kontratës.
   Përmbushja e këtij kushti duhet të dëshmohet përmes dokumentacionit vërtetues të lëshuar nga autoritete publikë/autoritete portualë.

2. Të paraqesë listën e personelit kryesor përgjegjës për zbatimin e kontratës aktuale që disponon, që përfshin CV e tyre, kualifikimet arsimore dhe profesionale dhe eksperiencën e tyre në sipërmarrjen e operacioneve detare në gjithë zinxhirin logjistik të transportit dhe përpunimit të mallrave përmes kontejnerëve. Do të konsiderohet avantazh eksperienca në rajonin e Adriatikut. Ky element mund të të dëshmohet përmes dokumentacionit vërtetues të lëshuar nga autoritete publikë/autoritete portualë.

3. Ofertuesi duhet të dëshmojë eksperiencë në operimin e terminaleve të kontejnerëve për të paktën **5 vitet** e fundit. Përmbushja e këtij kushti duhet të dëshmohet përmes dokumentacionit vërtetues të lëshuar nga autoritete publikë/autoritete portualë.

4. Ofertuesi duhet të paraqesë një çertifikatë qe vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqerisë, sipas standardardit ndërkombëtar ISO 9001 ose ekuivalente. Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

5. Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi të forcës punëtore për minimalisht 90 punonjës, duke evidentuar punësimin e të paktën 6 punonjësve të kualifikuar në pozicione manaxheriale (drejtues terminali, drejtues për gatishmërinë teknike, etj.), të cilët (këta të fundit) duhet të kenë të paktën 5 vite eksperiencë në menaxhimin dhe operimin e terminaleve të kontejnerëve. Përmbushja e këtij kushti duhet të dëshmohet përmes CV-së së stafit, dëshmisë së punësimit sipas legjislacionit vendas ose vendit të origjinës dhe kualifikimeve përkatëse.

   Gjithashtu, Ofertuesi duhet të deklarojë se ka kapacitet forcë punëtore për operim në Terminalin e Konteinerëve të cilët duhet të jenë të kualifikuar për përshkrimet e punës si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Drejtues Terminali | Vendos objektivat e Terminalit të Konteinerëve dhe të planit të përgjegjësive dhe të implementon kërkesat për staf terminali, kohë, financa, dhe sigurinë (safety & security) dhe burimet materiale për realizimin e tyre.<br>Eshte plotësisht i përgjegjshëm për arritjet e Terminalit të Konteinerëve për performancën e rënë dakort, zhvillimin, kapacitetet, financën, sigurinë dhe objektivat e burimeve njerëzore nën udhëzimin e përgjithshëm dhe i raporton Drejtorit të Operacioneve<br>Portuale. |
| 2 | Specialist performance Operacionale dhe Ekonomike | Menaxhon dhe mban përgjegjësi për realizimin dhe përmirësimin në vazhdimësi të gjithë treguesve operacionalë të terminalit duke siguruar akses të menjëhershëm dhe monitorim të performancës së anijeve dhe të gjithë operatorëve pjesëmarrës ne operacionet e ngarkim-shkarkimit.<br>Menaxhon dhe mban përgjegjësi për realizimin dhe përmirësimin në vazhdimësi të treguesve të performancës ekonomike të terminalit, përgatitjen e buxheteve dhe alokimin e burimeve si dhe zhvillimin e planeve strategjike financiare dhe të marketingut. |
| 3 | Dispecer Operacional | Organizon, drejton dhe kontrollon veprimtarine e Terminalit ne funksion te realizimit te planit te perpunimit konteinereve |

| | | |
|---|---|---|
| | | dhe detyrave te ngarkuara nga Drejtori Operacional, gjate turnit te cilin ai drejton. |
| 4 | Brigadier Operac. | Eshte pergjegjes per koordinimin e te gjithe aktivitetit operacional te perpunimit te konteinereve ne sheshin e terminalit. Bashkepunon me planifikuesin e sheshit per planifikimin dhe monitorimin e procesit te ngarkim/shkarkimit dhe stivimit te konteinereve ne sheshin e terminalit. Eshte pergjegjes per koordinimin e te gjitha aktiviteteve operative per perpunimin e konteinereve per cdo anije qe mberrin ne Terminalin e Konteinereve. Regjistron kohet e perpunimit te anijeve, kontrollon ngarkesat dhe evidenton te gjithe proceset qe kane te bejne me perpunimin e anijes ne formularin DSHO-SK 09. |
| 5 | Insp. Terminali | Kontrollon, regjistron, dhe arkivon levizjet ditore te konteinereve, brenda dhe jashte terminalit.<br>Eshte pergjegjes per kontrollin dhe monitorimin e mbarevajtjes se punes per hyrje / daljet dhe vendosjen e konteinereve ne terminal. |
| 6 | Sinjal., spont. | Drejton dhe komandon (me ane te radios ose shenjave perkatese) te gjitha veprimet dhe levizjet e operatorit te vincit gjate procesit te perpunimit te konteinereve ne kalate, sidomosne rastet me pamje te kufizuar. |
| 7 | Oper. Vinci MHC | Pergjegjes per drejtimin e vincit per shkarkimin dhe ngarkimin e Konteinereve nga anija ne kamion dhe anasjelltas, ne perputhje me listen e ngarkim/shkarkimit si dhe instruksionet e sinjalizuesit. |
| 8 | Oper. Mjeti TRACK | Eshte pergjegjes per drejtimin e kamionit per transportin e sigurt dhe ne kohe te konteinereve ne perputhje me rregullat dhe udhezimet perkatese. |
| 9 | Oper. Stivues K | Eshte pergjegjes per drejtimin e mekanizmit te ristakerit per ngarkim/shkarkimin e konteinereve ne terminal ne perputhje listen perkatese te ngarkim/shkarkimit si dhe udhezimet e pergjegjesit te turnit. |
| 10 | Oper. Forklift_12 T | Eshte pergjegjes per drejtimin e pirunit per ngarkim / shkarkimin, vendosje / zhvendosjen e konteinereve ne sheshin e terminalit. |
| 11 | Punetor Ng._Shk. | Kryen sherbimin e vendosjes/heqjes se ganxhave “tëist lock” te konteinereve ne perputhje me udhezimet perkatese te sinjalizuesit te vincit dhe operatorit te sheshit si dhe kryen procesin e mbushje-zbrazje konteineri. |

6 Ofertuesi duhet të dëshmojë eksperiencë në menaxhimin dhe operimin e makinerive dhe pajisjeve, për këtë qëllim duhet të dëshmojë posedimin e ligjshëm, në formën e pronësisë, qiramarrjes ose huapërdorje per mjetet dhe pajisjet si vijon:

- Vinça cope minimalisht 3 auto vinça te tonazhit te larte mbi 100 ton .
- Reach stacker minimalisht 6 me kapacitet ngritës 45 ton
- Lefterak me kapacietet ngritës 5 ton minimalisht 2 cope

- Lefterak me  kapacitet ngritës 20 ton minimalisht 2 cope
- Shasi transportuese me kapacitet mbajtës 40 ton minimalisht 6 cope
- Koka tërheqëse (Kamion)   minimalisht 6 Cope

Për ato mjete të cilat ofertuesi i disponon, të dëshmojë posedimin e ligjshëm, në formën e pronësisë, qiramarrjes ose huapërdorje si dhe skeda teknike për secilin mjet.

Gjithashtu duhet shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- *Dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje Qarkullimi* ***dhe***
- *Çertifikatën e Kontrollit Teknik (të vlefshëm)* ***dhe***
- *Siguracion e mjetit (të vlefshëm)* ***dhe***

Kontrata e qirasë apo huapërdorjes duhet të vlefshme sa afati i zbatimit të kontratës, dhe skedat teknike përkatëse dhe në momentin e hapjes së ofertës të jenë në zotërim dhe në gjendje magazine te ofertuesit dhe nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument që dëshmon posedimin e ligjshëm ( faturë blerje ose kontratë shitblerje) për disponimin e Sistemit lnformativ dhe Menaxhues te Terminalit të Kontejnerëve (Terminal Operating System - TOS) në operim në kontrata aktuale apo të shkuara, bashkë me përshkrimin e detajuar të funksionaliteteve të këtij sistemi.

8. Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës përcakton personin përgjegjës për ndjekjen dhe kryerjen e shërbimeve të operimit, të mirëmbajtjes dhe pozicionet e tjera drejtuese si dhe  CV-të përkatëse, dëshmitë e punësimit dhe kualifikimeve përkatëse, si dhe deklarata të përbashkëta të ofertuesit dhe individëve përkatës ku të shprehet gatishmëria për të punuar në terminalin e kontejnerëve për ofertuesin në rast se ky i fundit shpallet fitues.

9. Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e të gjitha shërbimeve të mirëmbajtjes për furnizim-vendosje dhe riparime, me materiale të çertifikuara (CE ose ekuivalente) dhe të përshtatshme, për mjetet e paisjet qe do te marre ne perdorim me ane te te nje kontrate qeramarrje ose huaperdorimi qe do  te nenshkruaje  autoriteti kontraktor pa asnjë detyrim shtesë për Autoritetin Kontraktor, në rast se do te pranon te operojë me te gjitha ose një pjesë të mjeteve e paisjeve të Autoritetit Kontraktor.

10. Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të garantojë se puna do të kryhet në përputhje me të gjitha rregullat e imponuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi, veçanërisht në lidhje me garantimin e rregullave të sigurisë në punë, të mbrojtjes së jetës, shëndetit, pasurisë dhe mjedisit. Përmes këtij deklarate, ofertuesi garanton se do të jetë i vetmi përgjegjës për çdo shkelje apo dëm që vjen si rezultat i operimit prej tij të makinerive dhe pajisjeve në terminal.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqip ose anglisht si dhe në rastin e dokumenteve të lëshuara nga autoritete publikë, t'i certifikojnë ato me vulën "Apostille". Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Në rastin e moslëshimit në vendin e origjinës të dokumentave të kërkuara sipas kritereve të mësipërme, në rastin e ofertuesve të huaj, do të paraqiten dokumenta të lëshuar sipas legjislacionit të vendit të origjinës ose të paraqiten dokumenta ekuivalente me to ose deklaratë me shkrim. Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të kryejë verifikimet e nevojshme me pasojë skualifikimin e ofertuesit në rast se ndonjë nga zërat e kërkuar të vërtetuar përmes deklarimit, vërtetohet me dokumentacionin e kërkuar në këto dokumente.

**Shtojca 11**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

**Përshkrimi i të dhënave teknike të objektit të prokurimit** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

**KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 12**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

## PLANIFIKIMI I
## KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

| ☐ Shërbim:<br>Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____ | | |
|---|---|---|
| **Kontrata Nr.** | **Titulli i Kontratës** | **Përshkrim i shkurtër i kontratës** |
| **01** | __________ | _______________ |
| **02** | __________ | _______________ |
| **03** | __________ | _______________ |
| **…** | __________ | _______________ |

**Shtojca 13**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

## SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

"Dhënia e shërbimit të menaxhimit dhe operimit të terminalit të konteinerëve në portin e durrësit tek operatorë portualë privatë të specializuar."

| | | | PERIUDHA 5 VITE | |
|---|---|---|---|---|
| **NR** | **PËRSHKRIMI I SHËRBIMEVE** | **NJËSIA** | **SASIA** | **SASIA E NDARE TEU 10"/20"** |
| | | | | |
| **1** | **Shkarkim** Konteinerë 10" 20" **PLOT** | cp/knt | 111,750 | 111,750 |
| | **Shkarkim** Konteinerë 40" 45" **PLOT** | cp/knt | 95,550 | 191,100 |
| | **Shkarkim** Konteinerë 10" 20" BOSH | cp/knt | 28,950 | 28,950 |
| | **Shkarkim** Konteinerë 40" 45" BOSH | cp/knt | 80 | 160 |
| | | | | |
| **2** | **Ngarkim** Konteinerë 10" 20" **PLOT** | cp/knt | 95,860 | 95,860 |
| | **Ngarkim** Konteinerë 40" 45" **PLOT** | cp/knt | 5,250 | 10,500 |
| | **Ngarkim** Konteinerë 10" 20" BOSH | cp/knt | 45,405 | 45,405 |
| | **Ngarkim** Konteinerë 40" 45" BOSH | cp/knt | 90,270 | 180,540 |
| | **TOTALI TEU 10"/20"** | | | **664,265** |
| | | **NJËSIA** | **SASIA** | |
| **3** | **Hapje/Mbyllje kap. (komp cikli)** | cp | 6,850 | |
| | **Lëvizje ekstra/kapje Bosh** | cp/knt | 34,650 | |
| | **Lëvizje ekstra/kapje Plot** | cp/knt | 11,610 | |
| | **Lashing-Unlashing** | cp/knt | 473,120 | |
| | **Ristivime spostime[Shifting]** | cp/knt | 2,035 | |
| | | | | |
| **4** | **Tarifa e mjeteve** | cp/knt | 473,120 | |
| | | | | |
| **5** | **Peshimi konteinereve** | cp/knt | 1,160 | |
| | | | | |
| **6** | **Energji elektrike ( kont** | knt/dite | 189,525 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Frigoriferike)** | | | |
| | | | | |
| **7** | **Magazinim kont. 6-15 dite** | knt/dite | 1,043,425 | |
| | **Magazinim kont. 16-20 dite** | knt/dite | 138,865 | |
| | **Magazinim kont. mbi 20 dite** | knt/dite | 364,085 | |
| | | | | |
| **8** | **Parkim (deri 3.5 T)** | dite | 23,655 | |
| | **Parkim (3.5 T - 7.5 T)** | | 5 | |

**Afatet e ekzekutimit: 5 (pese) vjet.**

**Shtojca 14**

( *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

## TERMAT E REFERENCES

## OBJEKTI DHE QËLLIMI I SHËRBIMEVE:

Porti i Durrësit eshte porti më i madh në Shqipëri dhe ndër më të mëdhenjtë në hapësirën Adriatiko-Joniane, dhe eshte një nyje shumë e rëndësishme për tregun vendas, rajonal dhe ndërkombetar. Porti i Durrësit është i pozicionuar në pjesën jug-perëndimore të qytetit të Durrësit. Infrastruktura operacionale e tij përbëhet nga 11 kalata me një thellësi kalate që varion nga 7.5m-11.5m. Volumet e mallrave të përpunuara në Portin e Durrësit përfaqësojnë më shumë se 85% të tregëtisë detare në nivel kombëtar. Porti i Durrësit është gjithashtu një vendndodhje kyçe për rrjetin e anijeve tregtare dhe veçanërisht anijeve me ngarkesa konteinerike, duke i dhënë Durrësit nje pozicion strategjik në lidhje me Korridorin VIII.

Kanali hyrës i portit eshtë në proces investimi për të mundesuar thellimin dhe rrjedhimisht rritjen e tonazhit të anijeve që bregëzohen në këtë port.

Terminali i konteinerëve perfshin kalaten 6, me nje gjatesi prej 300 ml dhe siperfaqe depozitimi 65.000 $m^2$. Kapaciteti depozitues i Terminalit te Konteinereve eshte 3000 TEU. Bazuar në sistemin aktual të menaxhimit dhe gjendjen aktuale të mjeteve dhe pajisjeve që përdoren në terminal, kapaciteti vjetor përpunues i Terminalit eshte 150.000 TEU (sistemi Reach Stacker)

Terminali i konteinereve, prej vitesh synon arritjen e objektivave të mëposhtme:

- Rritjen e kapacitetit përpunues dhe përmirësimin e infrastrukturës së Portit nëpërmjet implementimit të teknikave moderne të menaxhimit, teknologjise dhe metodave bashkëkohore të përpunimit te kontenierëve.
- Krijimi i një platforme efiçente për përdorimin e Portit të Durrësit për klientë dhe operatorë nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe vendet e tjera të rajonit.
- Përdorimi i Portit të Durrësit si Port tranzit në Rajon.
- Forcimi i pozicionit konkurues të Portit të Durrësit në rajon.
- Optimizimi i proceseve në gjithë gamën e shërbimeve të zinxhirit llogjistik.

Njëherazi me objektivave të mësipër synohet që impakti social i operimit të terminalit të kontejnerëve të jetë sa më i ulët, duke ruajtur sa është e mundur numrin e të punësuarve aktualë në terminal.

1. **PERSHKRIM I SHERBIMEVE OPERACIONALE TE TERMINALIT TE KONTEINEREVE:**

Ne Terminal realizohet menaxhimi, operimi, mirembajtja dhe permiresimi teknik si edhe adaptimi per te permbushur kerkesat aktuale dhe te ardhshme te trafikut ne Portin e Durresit duke perfshire ngarkimin dhe shkarkimin e anijeve konteinerike, aktivitetet e lidhura si depozitim konteineresh, magazinim, levizje ekstra, transportim, spontimi, mbushje-zbrazje, shifting, 24 ore per 7 dite te javes, perfshire marrjen e masave te burimeve te kerkuara per mjete, pajisje, sisteme, praktika, procedura, programe, organizim dhe burime njerezore ne perputhje me praktikat me te mira industriale, konkretisht:

**SHERBIMI I NGARKIM-SHKARKIMIT**

**Në rastin e shkarkimit të anijeve, shërbimi përfshin:**

- Shkarkimin e konteinerit nën drejtimin e komandës së anijes nga hambari ose kuverta e anijes, në pikën e shkarkimit në kalatën e portit.
- Lëvizja e konteinerit nga pika e shkarkimit për në vendin (slotin) e caktuar në sheshin e portit (terminalit të kalatës së anijes);
- Dërgimi (ngarkimi) i konteinerit nga pika e shkarkimit në zonën (slotin) e caktuar të sheshit të portit (terminalit), për në kamionin e marrësit të ngarkesës.
- Kontrollin dhe regjistrimin e numrit dhe të vulës së konteinerit;
- Lërimin ose mbërthimin e përshtatësve para ose pas përpunimit për proçesin e ngarkim /shkarkimit (ship-to-shore handling);
- Përgatitjen e an Equipment Interchange Receipt (EIR)
- Regjistrimin e pozicionit të Konteinerit në Shesh.

**Në rastin e ngarkimit të anijes, shërbimi përfshin:**

- Marrjen e konteinerit nga automjeti i dërguesit, në zonën e marrjes së terminalit dhe lëvizjen e tij në slotin e caktuar të terminalit;
- Lëvizja e konteinerit nga pika e depozitimit (në slotin e caktuar në terminalin e portit) për në pikën e ngarkimit përgjatë anijes;
- Ngarkimi i konteinerit në kuvertën e anijes, nën drejtimin e komandës së anijes, në hambarin ose kuvertën e Anijes në përputhje me planin e komandës së anijes për stivimin e ngarkesës.
- Kontrollin dhe regjistrimin e numrit dhe të vulës së konteinerit;
- Lërimin ose mbërthimin e përshtatësve para ose pas përpunimit për proçesin e ngarkim /shkarkimit (shore-to-ship handling);
- Përgatitjen e Equipment Interchange Receipt (EIR);
- Rregjistrimin e pozicionit të Konteinerit në Shesh.

**SHERBIME TE TJERA:**

- Rregjistrimin e pozicionit të Konteinerit në Shesh.
- Depozitim konteineresh (storage)
- Peshimi i konteinerëve
- Leximin, regjistrimin dhe kontrollimin e temperaturës.
- Furnizimi me energji elektrike (heqja dhe vendosja e prizës) i konteinerëve frigoriferike
- Mbushja dhe zbrazja e konteinerëve
- Përpunimi extra i konteinerëve plot/bosh në shesh, per nevoja te ndryshme

**Per operacionet dhe sherbimet portuale ne Terminalin e Kontenieréve ne APD**

Lista e sherbimeve portuale te ofruara ne Terminalin e Konteinereve (TK), te ardhurat e te cilave mblidhen konform vlerave te percaktuara ne Librin e Tarifave[4] te APD jane:

| Nr | Zërat e Shërbimeve | Njësia |
|---|---|---|
| 1 | **Shkarkim** Konteinerë 10" 20" **PLOT** | cp/knt |
| | **Shkarkim** Konteinerë 40" 45" **PLOT** | cp/knt |
| | **Shkarkim** Konteinerë 10" 20" BOSH | cp/knt |
| | **Shkarkim** Konteinerë 40" 45" BOSH | cp/knt |
| 2 | **Ngarkim** Konteinerë 10" 20" **PLOT** | cp/knt |
| | **Ngarkim** Konteinerë 40" 45" **PLOT** | cp/knt |
| | **Ngarkim** Konteinerë 10" 20" BOSH | cp/knt |
| | **Ngarkim** Konteinerë 40" 45" BOSH | cp/knt |
| 3 | **Hapje/Mbyllje kap. (komp cikli)** | cp |
| | **Lëvizje ekstra/kapje Bosh** | cp/knt |
| | **Lëvizje ekstra/kapje Plot** | cp/knt |
| | **Lashing-Unlashing** | cp/knt |
| | **Ristivime spostime[Shifting]** | cp/knt |
| 4 | **Shtese Tarife +10%** | |
| | | |

[4] "Tarifat e Portit të Durrësit – Libri i Tarifave" janë hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr 9251 date 8.07.2004 "Kodi Detar i Republikës se Shqipërisë", Ligjit nr 9130 datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual Durrës" Kapitulli IV neni 35 e në vijim dhe VKM nr 596 datë 10.09.2004 "Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe për rioganizimin e tij", Udhëzimin e pëbashkët MTI & MF nr.1568/3 date 14.07.2015 dhe Udhezimin nr. 3078 date 14.06.2016

| | | |
|---|---|---|
| **5** | **Tarifa e mjeteve** | cp/knt |

| | | |
|---|---|---|
| **6** | **Peshimi konteinereve** | cp/knt |

| | | |
|---|---|---|
| **7** | **Energji elektrike ( kont Frigoriferike)** | dite |

| | | |
|---|---|---|
| **8.1** | **Magazinim kont. 6-15 dite** | dite |
| | **Magazinim kont. 16-20 dite** | dite |
| | **Magazinim kont. mbi 20 dite** | dite |
| **8.2** | **Magazinim kont. 6-15 dite j terminali** | dite |
| | **Magazinim kont.16-20 dite dite j terminali** | dite |
| | **Magazinim kont. mbi 20 dite dite j terminali** | dite |
| **9** | **Parkim (deri 3.5 T)** | dite |
| | **Parkim (3.5 T - 7.5 T)** | dite |

| | | |
|---|---|---|
| **10** | **Tarifa per Sig Portuale (20')** | cp/knt |
| | **Tarifa per Sig Portuale (40')** | cp/knt |

| | | |
|---|---|---|
| **11** | **Tarife kanali** | |
| | **Tarife kalate** | |

Aktualisht te ardhurat nga tarifat e sherbimeve ne rubriken 1-10 mbidhen nga agjencite spedicionere, kurse ato te 11 nga agjencite detare.

